


KONFERENCA DHE EKSPOZITA E PËRBASHKËT BALLKANIKE

TË PËRSHPEJTOJMË Ndryshimin

*Drejt Shërbimeve
të Sigurta, të Besueshme
dhe të Qëndrueshme*

THIRRJE PËR ABSTRAKTE

7-9 NËNTOR 2023
GOLEM, SHQIPËRI



SHUKALB
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË



SHUKOS
SHOQATA E UJËSJELLËSVE DHE KANALIZIMIT TË KOSOVËS

Konferenca dhe Ekspozita:
Programi i Konferencës:
Tel/faks SHUKALB:
Tel SHUKOS:

info@BalkansJointConference.org
program@BalkansJointConference.org
+355 42 245 101, Mob: +355 69 6012782
+383 38 526 873, Mob: +383 44 182 497, +383 44 926 646



SHUKALB dhe SHUKOS kanë kënaqësinë t'ju ftojnë të merrni pjesë në Programin e Konferencës dhe Ekspozitës së 11-të të Përbashkët Ballkanike, e cila do të mbahet **në datat 7 - 9 Nëntor, 2023** në **Golem, Shqipëri**, në **Grand Blue Fafa Resort**.

Tema e Konferencës “**Të Përshejtojmë Ndryshimin: Drejt Shërbimeve të Sigurta, të Besueshme dhe të Qëndrueshme**”, është frymëzuar nga Dita Botërore e Ujit 2023 dhe në veçanti këtë vit nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Ujin e mbajtur në mars në qytetin e Nju Jorkut, dhe ka të bëjë me përshejtimin e ndryshimeve për të arritur Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm 6 (OZHQ 6), duke siguruar akses në ujë të pastër dhe kanalizime për të gjithë.

Arritja e targeteve specifike të OZHQ 6 deri në vitin 2030 dhe arritja e aksesit universal në shërbime të sigurta, të besueshme dhe në të njëjtën kohë të menaxhuara në mënyrë efikase të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, mbetet ende një sfidë. Ndryshimi që duhet të ndodhë kërkon financime dhe investime të konsiderueshme veçanërisht kur bëhet fjalë për ujin e ndotur, qasje inovative dhe modernizimin e shërbimeve duke përfshirë dixhitalizimin, dhe një fokus të veçantë në kapitalin e çmuar njerëzor që menaxhon dhe ofron shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Gjithashtu, nevojitet më shumë bashkëpunim ndërmjet të gjithë aktorëve në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, në mënyrë që të përshejtohet ndryshimi që nevojitet.

Programi i Konferencës ofron një larmishmëri temash, që mbulojnë të gjithë aspektet e sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve duke përfshirë çështje politike, menaxheriale dhe teknike. Konferenca ofron një platformë ku të gjithë profesionistët në sektorin e ujit mblidhen, diskutojnë dhe shkëmbejnë informacion dhe ndajnë praktikën e tyre të mira mbi çështje me interes në sektorin e ujit.

Fuqia e Konferencës së Përbashkët Ballkanike, siç dëshmohet nga anketimet e pjesëmarrësve që janë kryer ndër vite, ka qënë gjithmonë cilësia dhe shumëllojshmëria e diskutimeve plenare, punimeve profesionale të prezantuara nga profesionistë të njohur në të dy vendet dhe më gjerë në rajon. SHUKOS dhe SHUKALB ju mirëpresin në Konferencën e Përbashkët për të ndarë interesin tonë të përbashkët për një mjedis ujor më të mirë në Rajonin e Ballkanit të Madh.

KOMITETI I PROGRAMIT

Komiteti i Programit Teknik të Konferencës përbëhet nga ekspertë të njohur nga Shqipëria dhe Kosova me përvojë të gjatë profesionale në sektorin e ujit. Komisioni do të jetë përgjegjës për të siguruar një balancë dhe cilësi të lartë të prezantimeve që do të mbahen gjatë Konferencës dhe përbëhet nga këta anëtarë:

Jovan Gjika, (Kryetar i Komitetit të Programit), Koordinator Projektsh, Agjencia Kombëtare e Ujësllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, Shqipëri

Prof. Dr. Enkelejda Gjinali, Lektore, Departamenti i Inxhinierisë së Mjedisit, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës, Shqipëri

Etleva Demiri, Përgjegjëse - Sektori Teknik & Licencave, Enti Rregullator i Ujit, Shqipëri

Valbona Paja, Zëvendës Drejtore e Përgjithshme, Shoqëria Ujësllës Kanalizime Shkodër, Shqipëri

Rozarta Pura, Këshilltare Ligjore, Shoqëria Rajonale Ujësllës Kanalizime Durrës, Shqipëri

Frosela Filo, Drejtor Tregtar, Shoqëria Rajonale Ujësllës Kanalizime Korçë, Shqipëri

Baton Begolli, Këshilltar për Politikën e Ujit, Këshilli Ndërmëntor i Ujërave, Zyra e Kryeministrit, Kosovë

Hajrije Morina, Drejtoreshë, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, ARRU, Kosovë

Laura Kusari, Professore, Fakulteti i Ndërtimit dhe Arkitekturës, Kosovë

Armend Avdiu, Koordinator i Zyrës së KE, Kompania Rajonale e Ujësllësit Prishtinë, Kosovë

Besnik Aliu, Udhëheqës i Zyrës Ligjore, Kompania Rajonale e Ujësllësit Bifurkacioni, Ferizaj, Kosovë

Dafina Sylja, Zëdhënëse, Kompania Rajonale e Ujësllësit Gjakovë, Kosovë

Niman Baliu, Ekspert për media, Kompania Rajonale e Ujësllësit Mitrovicë, Kosovë

TEMAT KRYESORE TË KONFERENCËS

Përpara dorëzimit të Prezantimit në PowerPoint që do të mbahet në Konferencë dhe Punimit të Plotë, autorët duhet të dorëzojnë një abstrakt bazuar në temat e paraqitura si më poshtë. Këto abstrakte do të vlerësohen nga Komiteti Teknik i Programit. Autorët e abstrakteve të përzgjedhura do të ftohen të sjellin punimin e tyre final dhe prezantimin në PowerPoint. Jeni të ftuar të paraqisni abstraktin tuaj duke përfshirë por jo duke u kufizuar në temat e mëposhtme:

QEVERISJA DHE POLITIKAT PËR SHOQËRITË UK

- Zhvillimi i Politikave për Qeverisjen e Shoqërive UK dhe Marrëdhëniet Institucionale.
- Përzgjedhja, Krijimi dhe Funksonimi i Bordeve Mbikëqyrëse.
- Drejtimi Menaxherial i Shoqërive dhe Organizimi Struktural.
- Rajonalizimi i Shërbimeve UK dhe Zbatimi i Marrëveshjeve për Sigurimin e Shërbimit.
- Qeverisja e Korporatave.
- Partneriteti Publik Privat.
- Marrëdhënia midis Shoqërive UK dhe Pushtetit Vendor.
- Menaxhimi i Sistemeve Rurale.
- Masat e ndërlidhura me pandeminë (COVID-19).

KUADRI RREGULLATOR

- Licencimi i Shoqërive UK.
- Procesi i Shqyrtimit dhe Miratimit të Tarifave.
- Analiza e Performancës së Shoqërive UK.
- Zhvillimi dhe Aplikimi i Standardeve të Shërbimit.

MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE

- Kapacitetet për Thithjen e Investimeve Kapitale në Vendet në Zhvillim.
- Metodatat e Vlerësimit të Situatës Aktuale dhe Prioritizimi i Nevojave të Investimeve.
- Zhvillimi i Masterplaneve Dinamike.
- Monitorimi i Investimeve dhe Qëndrueshmëria e tyre në kohë.

MENAXHIMI I BURIMEVE UJORE

- Ndryshimet Klimaterike.
- Balancimi i Kërkesës për Ujë me Zhvillimin e Burimeve të Reja.
- Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore.
- Monitorimi dhe Mbrojtja e Burimeve Ujore.
- Ujërat Ndërkufitare.
- Menaxhimi i Thatësirave dhe Përmbytjeve.

MENAXHIMI FINANCIAR I SHOQËRIVE

- Burimet e Financimit dhe Politika e Subvencioneve.
- Menaxhimi i Riskut Financiar.
- Hartimi, Zbatimi dhe Monitorimi i Planeve 5 vjeçare të Biznesit.
- Raportimi Financiar për të Mbështetur Përmirësimin e Performancës.
- Instrumentet për Kontrollin e Brendshëm.
- Menaxhimi i Borxhit.

MENAXHIMI I OPERIMIT TEKNIK TË SHOQËRIVE UK

- Vlerësimi i Analizës së Kërkesës për Ujë.
- Praktikat e Matjes së Konsumit të Ujit.
- Zvogëlimi i Humbjeve të Ujit, Praktika dhe Përvoja.
- Planifikimi Inxhinierik dhe Dixhitalizimi i Zonës së Shërbimit (GIS).
- Aplikimi i Modeleve Hidraulike, Praktika dhe Përvoja.
- Rritja e Përdorimit të Sistemit SCADA, për Operimin e Sistemeve të Ujësjetësive.
- Menaxhimi i Sigurisë së Ujit dhe Krizave.
- Benchmarking.
- Eficenca e Energjisë në Shoqëritë UK.
- Menaxhimi i Integruar i Aseteve të Shoqërisë.
- Siguria dhe Shëndeti në Punë.

MENAXHIMI I UJIT TË NDOTUR DHE LLUMIT

- Uji i Ndotur në Kontekstin e Ekonomisë Qarkulluese.
- Qeverisja dhe Politikatat për Ujin e Ndotur
- Ndërtimi dhe Operimi i Impianteve të Trajtitimit të Ujit të Ndotur.
- Sistemet dhe Sfidat e Ndërtimit të Impianteve të Trajtitimit të Ujit të Ndotur.
- Zgjedhja e Teknologjisë së Trajtitimit për Sistemet e Vogla dhe Rurale.
- Trajtimi i Llumit dhe Ripërdorimi.
- Përdorimi i Llumit për Prodhimin e Energjisë.

SHËRBIMI NDAJ KLIENTIT

- Eficenca Komerciale.
- Organizimi dhe Funksonimi i Departamentit të Shërbimit me Klientin.
- Menaxhimi i Bazës së të Dhënave të Konsumatorit.
- Kontratat e Shërbimit me Klientin.
- Menaxhimi i Marrëdhënieve dhe Komunikimit me Publikun.
- Përdorimi i GIS për Menaxhimin e Ankesave të Klientëve.
- Zbatimi i Politikave për Ndërrprerjen e Shërbimit në rast Mospagese.

MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Politika e Punësimit.
- Vlerësimi i Nevojave për Trajnime dhe Zhvillimi i Kapaciteteve.
- Trajnimi dhe Certifikimi i Bazuar në Testim.
- Vlerësimi Vjetor i Performancës së Punës së Stafit.

AFATET KRYESORE DHE GJUHËT ZYRTARE TË KONFERENCËS

| | |
|-------------------------------------------------|------------------|
| Dorëzimi i Abstrakteve: | 15 Shtator, 2023 |
| Pranimi /Konfirmimi i Abstrakteve: | 26 Shtator, 2023 |
| Dorëzimi i Biografisë të Shkurtër Profesionale: | 13 Tetor, 2023 |
| Programi i Avancuar: | 20 Tetor, 2023 |
| Dorëzimi i Prezantimeve powerpoint: | 03 Nëntor, 2023 |
| Dorëzimi i Punimeve finale: | 15 Nëntor, 2023 |

Konferenca do të zhvillohet në shqip dhe anglisht.

Përkthimi simultan do të sigurohet përgjatë gjithë ditëve të organizimit të saj.

UDHËZIME TË PËRGJITHSHME MBI ABSTRAKTET

Autorët që do të dorëzojnë abstraktet deri më datën **15 Shtator, 2023**, duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Abstraktet mund të dorëzohen në gjuhët Shqip dhe/ose Anglisht.
- Format i abstraktit duhet të jetë sipas këtyre specifikimeve:
 - deri në 350 fjalë
 - dokument "MS Word"
 - shkronja Times New Roman, 11pt.
- Abstraktet duhet të përfshijnë këtë informacion:
 - Titullin e Materialit/Prezantimit
 - Emrin e Autorit/ Pozicionin e tij/ Institucionit/ Shteti
 - Kontaktet personale (e-mail, adresë postare dhe numër telefoni).
- Temën e Konferencës së cilës i referohet.
- Qëllimin e punimit, çështjet/problemet kryesore, metodologjin e përdorur dhe rezultatet dhe përfundimet e nxjerra.

Për më shumë informacion mbi dorëzimin e abstrakteve ndiqni udhëzimet në këtë [faqe të konferencës](#).

Autorët e abstrakteve të përzgjedhura do të njoftohen deri më datë **26 Shtator, 2023** dhe do të duhet të dorëzojnë profilet e tyre të shkurtra deri më datën **13 Tetor, 2023**, prezantimin në PowerPoint deri më **03 Nëntor, 2023** dhe punimin e plotë pas Konferencës, **15 Nëntor, 2023**.

Udhëzimet për dorëzimin e materialit të plotë janë të disponueshme në këtë [faqe të konferencës](#).

KONTAKTET

Për më shumë informacion rreth Programit Teknik:
program@balkansjointconference.org
www.balkansjointconference.org

Nadire Vitija (SHUKOS): Tel: +383 38 600 873

Cel: +383 44 182 497

Jonida Ahmeti (SHUKALB): Tel: +355 42 245 101

Cel: +355 69 70 66 222

